



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 380/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Albulen Nrecaj anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor në Ferizaj, paraqitur kundër Emrush Hasanit kryesuesi Këshillit të Vendvotimit në 2502x/06R për shkak të gabimit në përshkrimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 23.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pasafatshme ankesa e Albulen Nrecaj anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor në Ferizaj

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 20.06.2014, nga Albulen Nrecaj anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor në Ferizaj, ku pretendon se në vendvotimin 2502X/06R kryesuesi i KVV-së 2502X/06R Emrush Hasani gjatë futjes së të dhënave të votave në FRK të kandidatëve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është tejkualuar një rubrikë pa qëllim duke u shënuar në mënyrë të gabuar votat e kandidatit të LVV-së në një rubrikë më lartë. Parashtruesi i ankesës kërkon që votat e kandidatëve të rinumërohen ose të përmissohet gabimi i bërë, dhe si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e Emrush Hasanit dhe FRK-në.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme sepse afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: “*Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave*

zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”. Pala ankuese ka paraqitur ankesën në PZAP, me datë 20.06.2014 çka nënkupton se ankesa në fjalë është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor që është brenda 24 orëve nga mbyllja e qendrës së votimit, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 380/2014 më datën 23.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.